




Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

NARRATIVAT NË MEDIAT ONLINE GJATE MUAJVE PRILL-QERSHOR

Prill- Qershor, 2024



PËRMBAJTJA

1	METODOLOGJIA	3
2	TË GJETURAT KRYESORE	4
3	SHEMBUJT NË GJUHËN SHQIPE	5-9
4	SHEMBUJT NË GJUHËN SERBE	10-11

NARRATIVAT NË MEDIAT ONLINE GJATE MUAJVE PRILL-QERSHOR

1 Koha e monitorimit

Prill- Qershor, 2024.

2 Fushë veprimi

Çrregullimi i informacionit në internet dhe mediat sociale: Uebfaqe, portalet online të lajmeve, Facebook, Youtube, TikTok dhe Instagram.

3 Mostra

Në gjuhën shqipe dhe serbe.

4 Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i çrregullimeve në mediat online në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, rreth zhvillimeve/ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë muajve prill - qershor në Kosovë.

Ky raport është përparitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Mbulueshmëria dhe kuptueshmëria e çrregullimit të informacionit në Kosovë”, që mbështetet nga NDI dhe USAID në Kosovë. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NDI dhe USAID në Kosovë

2. METODOLOGJIA

Qëllimi i Institutit Demokraci për zhvillim (D4D), është identifikimi dhe luftimi i lajmeve me çrregullim të informacionit, trend ky në rritje i përhapjes së lajmeve me çrregullim të informacionit. Institutit D4D, ka bërë monitorimin e mediave online dhe atyre sociale për të identifikuar lajmet/artikujt të cilat përmbajnë çrregullime të informacionit, përmes një platforme monitoruese, duke klasifikuar artikujt në bazë të kategorive: zhvillimet në veri; dialogu Kosovë-Serbi; gjuha e urrejtjes; dhuna online ndaj grave; ndasitë politike dhe ndikimi ndërkombëtar. Mediat online të cilat janë monitoruar përmes platformes kanë qenë mbi 100 media online vendore, të rajonit dhe ndërkombëtare, të selektuara në një platformë monitoruese. Monitorimi dhe analizimi i artikujve me çrregullim të informacionit është bërë paralelisht në dy mostra: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

Përzgjedhja e shembujve nga të dyja mostrat është bërë duke u bazuar në përmbajtjen e artikullit i cili ka shpërndarë: dezinformata, manipulim të fakteve, përmbajtje të paverifikuara, lajm të pavërtetë, teori konspirative, clickbait, gjuhë të urrejtjes, gjuhë ofenduese, gjuhë kërcënuese, nxitëse, artikuj me tituj tendencioz, dhe raportim të njëanshëm. Kategoritë të cilat kanë mbizotëruar gjatë muajve prill-qershor në mostrën e gjuhës shqipe kanë qenë: gjuha e urrejtjes ndaj grave, zhvillimet në veri, ndikimi nga jashtë kurse në mostrën në gjuhën serbe mbetet dialogu dhe zhvillimet në veri.

Prej secilës mostër janë verifikuar 1000 artikuj me lexueshmëri më të madhe. Në mostrën në gjuhën shqipe nga 1000 artikuj, rreth 385 kanë rezultuar me çrregullim të informacionit, kurse në mostrën në gjuhën serbe nga 1000 artikuj të analizuar, rreth 500 kanë rezultuar me çrregullim të informacionit.

3. TË GJETURAT KRYESORE

- Elementet spekulative - titujt që përdorin gjuhë me elemente spekulative në lidhje me konflikte të mundshme në Kosovë që nxisin gjuhë agresive ndëretnike duke rritur rrezikun e përshkallëzimit të konfliktit, dhe duke nënvlerësuar përpjekjet diplomatike të Kosovës dhe Serbisë për të promovuar paqen dhe stabilitetin. Shebujt e përfshirë nga dy gjuhët, shqip dhe serbisht tregojnë elemente të spekulimeve. Spekulumet ndodhin kur bëhen pohime ose nxjerrin përfundime bazuar në informacione jo të plota ose burime të pa verifikuara. Në një shkallë, spekulimi është i natyrshëm në parashikimin ose analizimin e ngjarjeve të ardhshme, mirëpo spekulimet e pabaza mund të paraqesin sfida për besueshmërinë e medias dhe saktësinë e informacionit të paraqitur në publik. Problemi kryesor në lidhje me spekulimin është potenciali për keqinformim të lexuesve.
- Propagandë dhe informata të paverifikuara - në mostrën në gjuhën serbe vazhdojnë narrativat e pavërteta kundër figurave politike në Kosovë, të cilat shpërndahen nga persona zyrtarë të sferës politike në Serbi si dhe nga mediat. Sa i përket marrëdhënieve Kosovë-Serbi, nga shembujt e përmendur, pas anëtarësimit të Kosovës në Këshillin Parlamentarë në NATO në muajin maj, vazhdojnë propaganda se serbët në veri do të kenë jetë edhe më të vështirë.
- Mizogjenia dhe nxitja e gjuhës së urrejtjes ndaj grave në Kosovë - gjatë monitorimit të lajmeve në mostrën në gjuhën shqipe janë vërejtur tituj me gjuhë fyese dhe nxitëse ndaj grave online. Publikime me gjuhë denigruese nxisin urrejtjes ndaj grave dhe kufizon përfshirjen e grave në institucione.

4. SHEMBUJ NË GJUHËN SHQIPE

Lajm i publikuar nga euronews.al me titull: **“Kush është i besuari i Biden që do emërohet “emisar special për njohjen e Kosovës”**. Lajmi tregon se SH.B. A-të do të dërgojnë një emisar sepçial për njohje të Kosovës nga 5 shtetet anëtare të BE-së, i cili do të jetë Edward Joseph.

“Presidenti i Shteteve të Bashkuara (SHBA), Joe Biden, duhet të emërojë një ‘emisar special për njohjen e Kosovës’ nga pesëshja e Bashkimit Evropian (BE) – Spanja, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Qipro. Biden propozoi Edward Joseph në këtë pozicion, ligjërues në shkollën e studimeve të avancuara ndërkombëtare në Universitetin “Johns Hopkins” në Uashington, në një raport të fundit.”- Euronews.al



Lajmi nuk është informatë zyrtare nga vetë Administrata Biden dhe nuk ka deklarata nga SH.B.A.-të që vërteton lajmin. Megjithatë një punim i publikuar në vitin 2022, në të cilin edhe Edward Joseph ishte bashkë autor dhe kordinator i projektit, sygjeron që SH.B.A-të të dërgojnë një emisar special për tu angazhuar në njohje e Kosovës nga vendet e BE-së. Mirëpo nuk ka ndonjë vendim që do të caktohet një emisar nga administrata e SH.B.A-ve e as ndonjë emër. Ky punim u mor si bazë për lajmin në fjalë e cila më vonë u përhap në media duke mos u dhënë lexuesve informatën e saktë mbi punimin e marrë. Punimi u ripublikua në Maj të vitit 2024 nga professori Edward Joseph në platformën X (ish-Twitter). Artikulli nga euronews.al konsiderohet dezinformatë pasi që cilësohet se ka përdorur informata të pavërteta, në të njejtën kohë edhe mediat e tjera që kanë shpërndarë lajmin e njejtë nuk kanë verifikuar burimin e informatës.

- 
Klan Kosova Q matches
 6   Presidenti Biden me Emisar Special për njohjen e Kosovës nga pesëshja e BE-së
 ↗ 219 engagements  low  28  57  one month ago
- 
ATV Live Q matches
 47   Biden me emisar special për njohjen e Kosovës nga pesëshja e BE-së
 ↗ 46 engagements  low  1  3  one month ago
- 
Indeks online Q matches
 12   Presidenti Biden me Emisar Special për njohjen e Kosovës nga pesëshja e BE-së
 ↗ 132 engagements  low  20  1  one month ago
- 
Specbuk Q matches
 10   Presidenti Biden me Emisar Special për njohjen e Kosovës nga pesëshja e BE-së Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden...
 ↗ 139 engagements  125  11  3  one month ago

Biden me emisar special për njohjen e Kosovës nga pesëshja e BE-së

“Biden propozoi Edward Joseph në këtë pozicion, ligjërues në shkollën e studimeve të avancuara ndërkombëtare në Universitetin “Johns Hopkins” në Uashington, në një raport të fundit.”-Gazeta Blic

Biden me emisar special për njohjen e Kosovës nga pesëshja e BE-së

“Biden propozoi Edward Joseph në këtë pozicion, ligjërues në shkollën e studimeve të avancuara ndërkombëtare në Universitetin “Johns Hopkins” në Uashington, në një raport të fundit.”- ATV-portali

Bidenit i propozohet të emërojë emisar Special për njohjen e Kosovës nga pesëshja e BE-së

Lajmi nga disa media u përmirësua e nga disat të tjera u fshi. Ky lajm ka arritur të grumbulloj 979 ndërveprime, 133 pëlqime, 78 komente dhe 243 shpërndarje.

Kryeministri i Kosovës Kurti, gjatë vizitës zyrtare në Turqi, ka vizituar edhe kompaninë turke të aviacionit Baykar, e njëjta kompani që Kosova ka blerë dronët e quajtur Bayraktar. Z. Kurti ka publikuar disa fotografi në një postim në Facebook, ku shihet tek mban një prototip të avionit të quajtur “Kizilelma” që përkthehet molla e kuqe në shqip, emri në fjalë u përdor për të informuar publikun se Kosova po pajiset me avionë të rinjë. Mirëpo në postim nuk thuhet që Kosova do të pajiset me mjete të reja ushtarake apo avionë. Siç raportohet online:

Kosova e forcon armatimin, serbia i zbutë fjalët. Emri i këtijë droni është “Molla kuqe”, interesant!- Peja news

Albin Kurti “kërcënon” Serbinë me Mollën e Kuqe/ Gjinovci zbardh detajin interesant- Bota sot

Pas Bayraktar, Kurti ia ”mësyn” dronëve Kizilelma - Indeksi online





Positimi i Albin Kurtit:

“Baykar është kompani pioniere turke në industrinë e mbrojtjes dhe aviacionit. Ajo është kompania e parë turke që ka prodhuar fluturake ushtarake pa pilot apo dronë, siç njihen. Deri tani është e njohur ndërkombëtarisht për prodhimin e dronëve Bayraktar TB-2, të cilët i ka në arsenalin e saj edhe ushtria e jonë. Sot, në ambientet e kompanisë, u mirëprita nga vëllezërit, Bayraktar, Haluk dhe Selçuk. Haluk mban medaljen “Shërbim të Shquar”, që njëherësh është edhe mirënjohja më e lartë ushtarake në vendin tonë, për vullnetin, gatishmërinë dhe bashkëpunimin me Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Aty pashë nga afër dhe prototipin e fluturakes luftarake pa pilot të kësaj kompanie, Kizilelma.

Lajmet e pavërteta dhe jo të verifikuara shpesh shërbejnë për motive të ndryshme, si ndikimi i opinionit publik apo edhe tërheqja e klikimeve (clickbait). Artikujt e lartpërmendur kanë mbledhur 596 ndërveprime, prej të cilave janë 309 pëlqime, 50 komente dhe 32 shpërndarje.

Mizogjenia dhe dhuna online ndaj grave

Në mostrën në gjuhën shqipe vazhdimisht kemi hasur në gjuhë mizogjene ndaj grave në rrjete sociale si në shembullin e dhënë:

Gazeta Demos ka publikuar një video ne Instagram me titull: **“Gjyqtari ‘ia rrah’ tavolinën avokates së Hajdar Beqës”**. Video në fjalë përmban pamje nga seanca e gjykimit të deputetëve të cilët u përleshën fizikisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në videon e postuar shihet avokatja Besiana Ismajli duke argumentuar derisa ndërpritet nga gjyqtari pasi që nuk ja kishte dhënë fjalën avokates.

Raportimi nga mediumi Demos, shihet të ketë përdorur një gjuhë me elemente mizogjene e cila nuk kontribuon në informimin e qytetarëve për rastin gjyqësor në fjalë, por fokusohet te një moment teknik që nuk ka lidhje me ndonjë zhvillim të mëtutjeshme të rastit. Shprehja “ia rrah tavolinën” edhe nëse vendoset në thonjëza nuk arsyeton përzgjedhjen e fjalëve ndaj avokates znj. Ismajli. Për më tepër znj. Ismajli nuk është avokatja z. Beqa, por e z. Lushtaku, andaj edhe përskrimi i keqinformon qytetarët.



Si pasojë e shprehjes së përdorur në titullin e postimit është nxitur një gjuhë fyese jo vetëm ndaj z. Ismajli po edhe ndaj gjyqtarit Eroll Gashi, dhe është shembull se si një gjuhë fyese nxitë lexuesit për të përdorur një gjuhë të tillë, dhe u jep përshtypje se shprehje të tilla fyese janë në normale për tu përdorur.

Postimi ka grumbulluar në instagram 219 ndërveprime, 23 pëlqime dhe 84 komente.

6. SHEMBUJ NË GJUHËN SERBE

Me anëtarësimin e Kosovës në Këshillin Parlamentar të NATO-s si anëtar i asociuar, në mostrën në gjuhën serbe ka pasur kryesisht narrativa negative kundrejt Kosovës. Shumë media dhe figura publike kanë deklaruar se Kosova po shpërblehet për “torturën” që po ushtron mbi serbët e Kosovës.

Miliçević: Anëtarësimi i asociuar i Prishtinës në NATO është konfirmim i standardeve të dyfishta

“Vendimi që e ashtuquajtura Kosovë të bëhet anëtare i përkeqësoi edhe më shumë kushtet e jetesës për çdo serb në Kosovë” VIDEO

Kojçiq dhe Rakiq: Anëtarësimi i asociuar i Prishtinës në Këshillin e Sigurimit të NATO-s është një sinjal i fortë kërcënimi në rajon.

Kosova anëtare e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, reagon Petković



Shumë media dhe figura politike në Serbi kanë përcjellur narrativa të ngjajshme për anëtarësimin e Kosovës në Asamblesë Parlamentare të NATO-s si një ngjarje që paraqet një sinjal të fortë kërcënimi në rajon, pas të cilit qëndron Perëndimi politik dhe NATO.

Për më tepër theksohet edhe se Perëndimi po e shpërblen Albin Kurtin për diskriminimin dhe torturën që po i bëhet serbëve të Kosovës. Gjithashtu si argument kundërshtues thuhet se është shkëlur rezoluta 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në kuadër të dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.


- 

19 Vreme [Q matches](#)
Petković: Pridruženo članstvo Kosova u PS NATO nagrada za Kurtijev teror
↗ 30 engagements ↻ 12 □ 8 ↻ 3 ⌚ one month ago
- 

20 Informer [Q matches](#)
Dvostruki aršini Zapadal Petković: NATO nagradio Albina Kurtija i Prištinu zbog pucanja na Srbe i višegodišnjeg terora nad napim narodom!
↗ 29 engagements ↻ 1 □ low ↻ 28 ⌚ one month ago
- 

21 Pravda [Q matches](#)
NESTOROVIĆ UPUTIO ŽESTOKE KRITIKE: Vučić prokrčio put "Kosovu" u NATO alijansu
↗ 28 engagements ↻ 13 □ 1 ↻ 14 ⌚ one month ago

Narrativa që përhapet pothuajse në të gjitha mediat në Serbi në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në Asamblenë e NATO-s si anëtar i asociuar, nxit ndarjet etnike dhe urrejtjes në mes serbëve dhe shqiptarëve, duke i ekspozuar me informata të pavërteta se jeta e qytetarëve serb do të vështirësohet edhe më shumë. Duke marrë parasysh se raportet Kosovë-Serbi kanë qenë çdo herë delikate, narrativat në fjalë rrezikojnë të thellojnë tensionet në mes Kosovës dhe Serbisë. Artikujt e lartë përmendur kanë grumbulluar 570 ndërveprime, prej të cilave 199 pëlqime, 123 komente dhe 284 shpërndarje.

-
- 

1 Informer [Q matches](#)
Šta sad ovo znači? Šokantna mapa na zvaničnom sajtu NATO!
↗ 111 engagements ↻ 103 □ low ↻ 8 ⌚ 3 months ago

Narrativa që përhapet pothuajse në të gjitha mediat në Serbi në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në Asamblenë e NATO-s si anëtar i asociuar, nxit ndarjet etnike dhe urrejtjes në mes serbëve dhe shqiptarëve, duke i ekspozuar me informata të pavërteta se jeta e qytetarëve serb do të vështirësohet edhe më shumë. Duke marrë parasysh se raportet Kosovë-Serbi kanë qenë çdo herë delikate, narrativat në fjalë rrezikojnë të sjellin konflikte.

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendimmarrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik. Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: **www.d4d-ks.org**

Mbështetur nga:

